



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta/ Ministry of Culture, Youth and Sport

Bazuar në rregulloren 05/2013 për ndarjen e çmimeve për dramë shqipe "Katarina Josipi" neni 8 pika 2 më poshtë gjeni kriteret për konkursin:

KONKURS

për ndarjen e Çmimeve për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi" për vitin 2024

Ftohen të gjithë dramaturgët që të konkurrojnë me dramat e tyre origjinale në Konkursin për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi" për vitin 2024.

Çmimet të cilat i ndanë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit janë si në vijim:

1. Çmimi i parë për Dramë origjinale Shqipe "Katarina Josipi"
2. Çmimi i dytë për Drame origjinale Shqipe "Katarina Josipi"
3. Çmimi i tretë për Dramë origjinale Shqipe "Katarina Josipi"

Vlerësimin për ndarjen e çmimeve e bën juria profesionale e përbërë nga 5 anëtarë e emëruar nga Ministri.

Tri dramat më të mira, fitojnë të drejtën për lexime skenike në Teatrin Kombëtar të Kosovës;

Drama e vlerësuar me çmimin e parë konsiderohet si dramë potenciale për inskenim në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Tre Çmimet për dramat më të mira, do të kenë shpërblim financiar me vlerë të caktuar sipas rregullores Nr. 05/2013, gjithashtu fituesit do të pranojnë nga një certifikatë të nënshkruar nga Ministri dhe një kopje origjinale të vendimit.

Çmimet dorëzohen në një ceremoni të veçantë të organizuar nga MKRS, me 9 nëntor në ditëlindjen e "Katarina Josipit".

Tre dramat fituese botohen në një edicion special në gjuhën shqipe;

Kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje

- Laureat të Çmimit mund të jenë dramaturgët që janë shtetas të Republikës së Kosovës.
- Dramat e papërfunduara apo sinopsiset nuk do të merren në shqyrtim.
- Drama duhet të jetë origjinale, të pa inskenuara, të pa botuara më parë dhe që nuk kanë pasur lexim skenik paraprak.
- Një autor mund të sjellë më së shumti dy drama për shqyrtim;
- Dramat që konkurrojnë në këtë konkurs duhet të jenë jo më të shkurtra se 40 minuta;
- Dramat e të gjitha zhanreve do të merren në shqyrtim;
- Zhanri, tema dhe as numri i personazheve nuk janë të limituara,
- Dramat dorëzohen në tri kopje me mbishkrimin "Konkursi për Dramë Kombëtare 'Katarina Josipi 2024'";

Autorët duhet të nënshkruhen me shifër dhe shifrat fituese do të shpallen në media për konfirmimin e emrave të fituesve. Për konfirmim të shifrës, autori duhet të sjell si dëshmi dramën origjinale.

Dramat duhen të dërgohet në Arkivin e MKRS-së, për Departamentin e Kulturës, në Zyrën nr. 022 (Adresa: MKRS, 10.000 Prishtinë, Rruga "Nëna Terezë" nr. 35). Autorët që sjellin dramat e tyre në këtë konkurs konsiderohet se i pranojnë kushtet e këtij konkursi.

Konkursi do të jetë i hapur nga dita e publikimit në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit deri me 01 Gusht 2024. Çdo Dramë e ardhur mbas kësaj date nuk do të merret në shqyrtim.

Kërkesat e autorëve me dokumentacion jo të kompletuar nuk do të shqyrtohen.